

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga kriza globale te vendimet lokale, çmimi në pompë i naftës mund të marrë “gaz” nga taksat e reja
ADRESA	https://www.gazetatema.net/ekonomia/nga-kriza-globale-te-vendimet-lokale-cmimi-ne-pompe-i-naftes-mund-te-ma-i586710
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 13:44:44 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 15:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1a885e8f9a77d8946c31cda9b5fb720baca22b0210b304b7eeae87ae387a9fc9
TEKSTI	dfbfc34a72024ac37029befc35be1c4ac477ff9a72ddced1dcd75ffecc7b1f1
PAMJA	19343dc765f4f6440dc38c1636542e98f98116bdf65c7d06fdda39c3b2a9f29f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b818374a56e31cdfa64fb08923f17131e67d3229c096a61a181b4baf1518f3fb
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b99bb89ad091208af3c2b8534814a2155c6e198d9adcb338cc8f4ec8b0016659
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b818374a56e31cdfa64fb08923f17131e67d3229c096a61a181b4baf1518f3fb>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

FAZ ngre pikëpyetje për denimet ndaj ish-krereve të UÇK-se: A janë proporcionale me ato të krimineleve serbe të luftës? Orkestra Simfonike çel sezonin e ri! Vite burg për fundit

Nga kriza globale te vendimet lokale, çmimi në pompë i naftës mund të marrë “gaz” nga taksat e reja



17 Shtator 2026, 17:40Ekonomia TEMA



Çmimet e karburanteve në Shqipëri mund të rriten më tej. Kjo, jo nga zhvillimet në Lindjen e Mesme që kanë shtrenjtuar naftën në bursa, por nga vetë qeveria. Në duzinën e taksave që rëndojnë në çdo litër naftë e benzinë do të shtohen edhe dy tarifa të tjera... gjurmimi dhe rezerva kombëtare e sigurisë.

“Vendosja e këtyre tarifave duhet parë në kontekstin e koston që ato do të krijojnë për operatorët dhe, në fund, për konsumatorin. Çdo detyrim i ri mbi zinxhirin e furnizimit ka potencialin të reflektohet në çmimin e produktit, veçanërisht në një treg ku karburantet tashmë kanë një peshë të konsiderueshme në shpenzimet e familjeve dhe bizneseve. Për këtë arsye, mënyra se si do të strukturohet dhe zbatohet ky mekanizëm do të jetë vendimtare”, deklaroi Eduart Gjokutaj, ekspert për ekonominë.

Shoqata e Hidrokarbureve paralajmëron se krijimi i rezervës së sigurisë me naftë bruto do të kërkojë investime shtesë për krijimin e kapaciteteve ruajtëse e përpunuese me qëllim hedhjen e naftës në tregun e pakicës. Nëse kostoja e krijimit dhe menaxhimit të rezervës së sigurisë, nuk do të përballohet totalisht nga shteti, Shoqata e Hidrokarbureve paralajmëron se kjo kosto shtesë do të transferohet te çmimi final.

“Rezerva strategjike është një mekanizëm që mund të ketë një funksion të rëndësishëm në rast të ndërprerjeve të furnizimit apo krizave të papritura. Por mënyra se si financohet është po aq e rëndësishme sa vetë krijimi i saj. Nëse barra financiare i lihet operatorëve ekonomikë, duhet parë me shumë kujdes se si kjo kosto do të përkthet në treg dhe nëse do të krijojë një presion të ri mbi çmimin që paguan konsumatori”, u shpreh Gjokutaj.

Projektligji i miratuar parashikon disa burime financimi për krijimin dhe mirëmbajtjen e sigurisë, përfshirë si kryesore tarifën e operatorëve ekonomikë. As krijimi i rezervës të sigurisë së karburanteve e menaxhuar nga një operator shtetëror nuk pritet të ketë efekt te ulja e çmimit të naftës për tregun e pakicës, por madje i shton karburanteve një tarifë të re.

“Në kushtet aktuale, çdo ndërhyrje në strukturën e çmimit duhet të shoqërohet me transparencë të plotë se sa është kostoja reale dhe kush do ta përballojë atë. Një ulje e akcizës e lidhur me një prag të caktuar mund të japë një lehtësim vetëm nëse çmimi arrin atë nivel, ndërsa deri atëherë konsumatori mbetet i ekspozuar ndaj luhatjeve të tregut. Pra, sfida është që masat të mos jenë vetëm reaguese, por të krijojnë një mekanizëm më të qëndrueshëm për përballimin e goditjeve të çmimeve”, tha eksperti Gjokutaj.

Me Bordin e Transparencës të rikthyer në fuqi dhe çmimet e karburanteve që po shkojnë drejt niveleve rekord, qeveria nuk ka ndër mend të ndërhyjë në tjetër mënyrë përveç se te akciza. Kjo e fundit do të ulet me 20 për qind vetëm kur nafta të kapërcejë nivelin e 220 lekëve. **(A2 Televizion)**



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Nga përdorimi në pronësi: Kadastra mbyll procesin për 522 Ha tokë bujqësore në Shijak](#)

11:28 Ekonomia

Vendimet e qeverisë/ Karakaçi: Rezerva e sigurisë së hidrokarbureve do të menaxhohet nga shteti, nis puna për mbikalimet në Kashar dhe Yrshek

15:20 Ekonomia

Rritja e çmimit të naftës, ministrja Ibrahimaj njofton ringritjen e Bordit të Transparencës

14:30 Ekonomia / 5 komente

ABI Bank konsolidon rritjen në gjashtëmuajorin e parë 2026

10:47 Ekonomia

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.